



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

***PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR***

(Mbajtur, më 27.02.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore me kandidatët e listuar më mirë dhe që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, civile dhe penale, të shpallur me vendimet nr.108, nr.109 dhe 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht me:

1. kandidatin z. {...};
2. kandidatin z. {...};
3. kandidatin z. {...}.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:03 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |

6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
8. *Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
9. *Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
11. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
12. *Charles Ericksen, USAID.*
13. *Erion Fejzulla, USAID.*
14. *Anisa Kuqi, EURALIUS.*
15. *Valbona Bala, USAID.*
16. *Përfaqësues të medias (prezent vetëm pikën e parë)*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore me kandidatët e listuar më mirë dhe që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, civile dhe penale, të shpallur me vendimet nr.108, nr.109 dhe 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht me:

1. kandidatin z. {...};
2. kandidatin z. {...};
3. kandidatin z. {...}.

Mbledhja plenare e datës 27 shkurt 2020 fillon me prezantimin e rendit të ditës nga ana e Kryetares së Këshillit, zonjës Naureda Llagami.

Pas prezantimit të rendit të ditës, nga ana e stafit ftohet të hyjë në sallën e mbledhjes kandidati i parë që do të intervistohet, i cili është zoti {...}.

(Hyn në sallën e mbledhjes kandidati zoti {...}.)

Fillimisht zotiti {...} i bëhet e ditur që intervistomi do të zgjasë 30 minuta dhe më pas i parashtrohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Naureda Llagami, pyetja e parë e cila lidhet me *arsyet, motivet dhe objektivat e kandidimit që synon të ndjekë zoti {...}, në qoftë se do të ishte nesër një anëtar i Gjykatës së Lartë në pozicionin e së drejtës administrative.*

Në përgjigje të kësaj, zoti {...} fillimisht bën një prezantim përmbledhës të përvojës dhe eksperiencës së tij mbi 33-vjeçare në sistemin e drejtësisë, duke shprehur motivim, vlerësim për arritjet në profesion në profile të ndryshme si: të prokurorit, juristit në administratë, avokatit, të gjyqtarit kushtetues, të drejtuesit të lartë të institucioneve publike dhe jopublike, të hartuesit të ligjeve, të punimeve të ndryshme shkencore dhe gradave shkencore.

Më pas zoti {...} përmend disa nga motivet të cilat e shtynë për të qenë pjesë e konkurrimit dhe ato janë si më poshtë:

-Eksperiencia e tij 28-vjeçare në fushën e së drejtës administrative, një vlerë kjo që

e motivon për të qenë pjesë e konkurrimit; Eksperienca 13-vjeçare si anëtar në Gjykatën Kushtetuese, dhe kjo përbën një avantazh; Arritja e objektivave nëpërmjet mandatit 9-vjeçar në Gjykatën e Lartë, dhe këtë ai e shikon si një sfidë dhe përgjegjësi shumë të madhe, duke u përballur me vështirësi pasi, sfidat në të cilat ndodhet sot Gjykata e Lartë, janë shumë të mëdha.

Më pas zoti {...} ndalet tek sfidat përpara të cilave ndodhet Gjykata e Lartë.

Për të, sfida kryesore i) është roli që duhet të kenë ata të cilët do të punojnë në Gjykatën e Lartë, për ta shndërruar Gjykatën e Lartë në një “gjykatë ligji”, në një gjykatë ashtu siç kushtetuta ka përcaktuar të jetë; ii) marrja e masave procedurale organizative për mënyrën sesi do të evadohet numri i çështjeve në këtë gjykatë; iii) dhënia e legjitimitetit të këtij institucioni, legjitimitet që e do opinionin publik, e do sistemi i drejtësisë.

Në kuadër të sfidave të sipërcituara u parashtruan dhe objektivat (të listuara me parë në platformën e kandidimit nga ana e z. {...}).

Një nga objektivat që ka parashtruar kandidati në pozicionin e një gjyqtari të ardhshëm është i) bërja e një strategjie e cila mungon për këtë gjykatë dhe kjo do të ishte një nga kërkesat e para që zoti {...} do kërkonte edhe nga kolegët e tij, ku në thelb do të ishte përshtatja organizative e Gjykatës së Lartë, ku Njësia e Shërbimit Ligjor të formatohej në kuptim të shtimit të numrit apo të ndihmohej me struktura të tjera administrative brenda asaj gjykate, kjo për të evaduar numrin e çështjeve të shumta që ka kjo gjykatë; ii) evidentimi i çështjeve sipas lëndës duke kaluar më pas tek projekti apo vendimi pilot, risi kjo që do të sillej për situatën që gjendet sot Gjykata e Lartë. Edhe vendimi pilot do të çonte në evadimin e çështjeve; iii) ridimensionimi kushtetues i Gjykatës së Lartë, duke e bërë këtë të fundit një gjykatë që unifikon praktikën, në veçanti për çështjen me lëndë administrative është objektivi kryesor në funksion të gjithë objektivave të sipërpërmendura. Gjithashtu kandidati ka përmendur në platformën e tij çështjet administrative të cilat kanë nevojë për unifikim; iv) në objektivat e synimet e kandidatit u reflektua dhe rëndësia e një rregulloreje të brendshme për të ndihmuar në mbarëvajtjen e punës së gjyqtarëve të kësaj gjykate; v) gjithashtu kandidati i jep rëndësi edhe marrëdhënies së gjykatës me median dhe publikun duke vlerësuar rolin e

magjistratit të medias, qenia më transparente e veprimtarisë së Gjykatës së Lartë, publikimit të vendimeve më të qarta dhe aksesueshmëri nga ana e publikut; vi) në pikën e fundit të objektivave kandidati parashtron riaktivizimin e veprimtarive profesionale me qëllim shkëmbimin e informacioneve dhe zhvillimeve më të reja të praktikës dhe të doktrinës juridike, si dhe qasjen me teknologjinë e informacionit.

Më pas zoti {...} pyetet nga zoti Maksim Qoku se ***cilët elementë të formimit dhe të eksperiencës personale e kanë përgatitur për të adresuar çdo aspekt që lidhet me juridiksionin e Gjykatës së Lartë?***

Një nga elementët që zoti {...} përmend është i) përvoja e gjatë e punës mbi 30-vjeçare si ekspert i së drejtës administrative, duke dhënë kontributin e tij në dhënien e vendimmarrjes. Një element tjetër është ii) përvoja vendimmarrëse si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ku duke ndërthurur elementët doktrinarë (mbi të cilët zoti {...} ka punuar nëpërmjet librave dhe artikujve) me elementët jurisprudencial, kjo gjë mundëson atë që duhet dhe ky do ishte një motiv i fortë për të bërë këtë detyrë.

Pyetja e tretë i drejtohet nga zoti Erjon Muharremaj i cili e pyet ***mbi rolin e Gjykatës së Lartë më gjerë në shoqëri.***

Në përgjigje të pyetjes së zotit Muharremaj, kandidati rithekson edhe një herë sfidën që ka kjo gjykatë, ajo e dhënies së legjitimitetit kësaj gjykate nëpërmjet vendimmarrjes së saj e cila duhet të përçohet rregullisht tek publiku. Sipas tij, përveç vendimmarrjes e cila është bazike, e rëndësishme është edhe mënyra sesi Gjykata e Lartë komunikon me median/publikun. Në fjalën e tij ai shton se sot kërkohet që Gjykata e Lartë të jetë e besueshme. Sipas tij, nëse arrihet që Gjykata e Lartë të ketë pritshmëri legjitime, atëherë edhe avokatët, gjyqtarët, doktrinarët do ta dinin se kush do të ishin pritshmëritë ndaj vendimmarrjeve në këtë gjykatë, ashtu siç shihet në standardin që Gjykata e Strasburgut ka vendosur.

Zonja Brikena Ukperaj i drejton pyetjen e katërt zotit {...}, e cila ka të bëjë me çështjen e backlog-ut dhe konkretisht ***cilat mund të jenë masat konkrete që mund të merren menjëherë për uljen e backlog-ut.***

Fillimisht zoti {...} shprehet se backlog-u në Gjykatën e Lartë është krijuar pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrime jo koherente, ku brenda të njëjtit kolegji janë mbajtur qëndrime të ndryshme. Sipas zotit {...}, evadimi i këtyre çështjeve do të bëhet nga gjyqtarët të cilët do të ndihmohen nga një trupë profesionistësh siç janë këshilltarët ligjorë si dhe Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Në fjalën e tij ai shprehet se do të ishte mirë që të kishte edhe struktura të tjera brenda gjykatës të cilat të mund të ndihmojnë, për përgatitjen e dosjeve, strukturën e shërbimit ligjor, siç mund të jenë specialistët pranë drejtorisë së studimeve apo qendra e dokumentacionit. Prandaj, sipas tij, hapi i parë do të ishte identifikimi i çështjeve, bërja e vendimeve unifikuese, shtimi i numrit të stafit administrativ të gjykatës me specialistë që ndihmojnë Njësinë e Shërbimit Ligjor.

Pyetja e fundit për zotin {...}, drejtohet nga zonja Marçela Shehu, e cila e pyet ***mbi dilemën etike më sfiduese që ka pasur në punë dhe si e ka zgjidhur atë.***

Zoti {...} sjell një rast kur punonte gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe ku ai ishte marrë me përgatitjen e Komentarit dhe Kodit të Procedurës Administrative në vitet 1999-2000, ku në njërin prej neneve ai kishte bërë vërejtje duke thënë se neni ishte i paqartë. Ky koment ishte marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, e cila në rrugën e gjykimit incidental, e kishte sjellë në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e këtij neni. Kjo çështje i caktohet zotit {...}, i cili pati dilemën se çfarë duhet të bënte përpara se të merrte vendimin, pasi në arsyetimin e vendimit ishte shkruar pikërisht ajo çka zoti {...} kishte komentuar në koment. Pas kësaj dileme ai kishte kërkuar dorëheqjen nga kjo çështje, kërkesë e cila nuk u pranua me arsyetimin se zoti {...}, pra gjyqtari nuk kishte dhënë opinion për antikushtetutshmërinë e normës. Më tej, zoti {...} shprehet se arrin ta dorëzojë si relator çështjen, por duke pritur mendimet e tetë kolegëve

në dhomë këshillimi të cilët e shfuqizuan dispozitën si antikueshtetuese dhe ku për formalitet edhe gjyqtari {...} ka ngritur dorën për shfuqizimin e saj. Ky ka qenë një moment i cili e ka bërë të reflektojë dhe të jetë më i vëmendshëm ndaj dhënies së komenteve për dispozita ligjore.

(Me këtë përgjigje përfundon edhe intervista e zotit {...}, i cili pasi falënderon anëtarët e Këshillit, largohet nga salla e mbledhjes.)

(Hyn në sallën e mbledhjes kandidati zoti {...}.)

Fillimisht zotit {...} i bëhet e ditur që intervistomi do të zgjasë 30 minuta dhe më pas i parashtrohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Naureda Llagami, pyetja e parë e cila lidhet me **arsyet, motivet dhe objektivat e kandidimit që synon të ndjekë zoti {...}, në qoftë se do të ishte nesër një anëtar i Gjykatës së Lartë në pozicionin e së drejtës civile.**

Zoti {...} përmend disa nga motivet të cilat e shtynë për të qenë pjesë e konkurrimit dhe ato janë si më poshtë:

-Përvoja si doktricien në dhënien e kontributit në fushën akademike për më shumë se 24 vjetësh pranë Fakultetit të Drejtësisë, fakultete private e gërshetuar me përvojën si përfaqësues ligjor para gjykatës për një periudhë mbi 10 vite;

Më pas zoti {...} gërsheton kontributin e tij, sfidat dhe objektivat e kandidimit, ku fillimisht rendit besimin e publikut në sistemin gjyqësor i cili ka rënë ndjeshëm dhe në aspektin profesional zoti {...} mund të japë kontributin e tij për rritjen e besimit të publikut për një gjykatë bindëse.

Gjithashtu edhe vlerat e tij etike dhe morale e karakterizojnë atë si një njeri punëtor, kritik me veten, duke kërkuar gjithmonë më të mirën. Sipas tij, këto janë garanci të kandidimit të tij, garanci të cilat do të jenë bindëse duke i arritur objektivat. Sërish zoti {...} rithekson kontributin e tij për rritjen e besimit të publikut me sistemin gjyqësor.

Më pas zoti {...} pyetet nga zoti Maksim Qoku se ***cilët elementë të formimit dhe të eksperiencës profesionale e kanë përgatitur atë për të adresuar çdo aspekt që lidhet***

me juridiksionin e Gjykatës së Lartë.

Në përgjigje të tij, zoti {...} rithekson faktin e të qenit njeri i doktrinës, si një pjesë e formimit të tij është edhe një pjesë e fortë të cilën kandidati mendon se e ka. Sipas tij, gjyqtari, përmes interpretimit, të përshtasë të drejtën dhe ta bëjë këtë të gjallë nëpërmjet jurisprudencës konstante dhe të japë një të drejtë e cila të jetë e perceptueshme nga publiku. Në fjalën e tij, zoti {...} shton që Gjykata e Lartë ka si mision të krijojë doktrinë, pra të shndërrohet nga një gjykatë e cila zbaton ligjin në një gjykatë e cila bëhet doktrinale e kështu, duke qenë një njeri i doktrinës, kjo përputhet me profilin që ka marrë sot Gjykata e Lartë, profilit të zhvillimit të doktrinës.

Pyetja e tretë i drejtohet nga zoti Erjon Muharremaj i cili e pyet *mbi rolin e Gjykatës së Lartë përtej sistemit gjyqësor dhe më gjerë në shoqëri.*

Ashtu siç përmendi edhe më lart, zoti {...} flet mbi situatën ku publiku ka ulur ndjeshëm besimin ndaj Gjykatës së Lartë (sistemit në përgjithësi) kjo pasi sistemi gjyqësor ka prodhuar vendime kontradiktore, haptazi abuzive apo vendime të cilat kanë cilësi të dobët arsyetimi.

Më pas zoti {...} shton në fjalën e tij se sistemi gjyqësor është ai që ruan balancën dhe kontrollon ligjshmërinë dhe kur një sistem gjyqësor nuk funksionon atëherë në një farë mënyre është cenuar parimi i shtetit të së drejtës. Sipas tij, njehsimi i jurisprudencës do të bënte që publiku të krijojë besimin pasi njehsimi sjell siguri juridike dhe barazi të palëve. Prandaj ndryshimet kushtetuese, sipas zotit {...} kanë qenë të nevojshme pasi sjellin premisën që do të synojë Gjykata e Lartë, atë drejt rritjes së besimit të publikut tek gjyqësori.

Zonja Brikena Ukperaj i drejton pyetjen e katërt zotit {...}, e cila ka të bëjë me çështjen e backlog-ut një nga sfidat që ka sot Gjykata e Lartë dhe konkretisht *cilat mund të jenë masat konkrete që mund të merren menjëherë për uljen e backlog-ut dhe që do të ishte e prekshme edhe për publikun.*

Në përgjigjen e dhënë prej tij, kandidati mendon se bekllog-u në Gjykatën e Lartë është fakt evident dhe duhet gjetur edhe një zgjidhje e cila mund të vijë nga një veprim i dyanshëm, veprime administrative që mund të marrë vetë Gjykata e Lartë në bashkëpunim edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor, por mund të jetë edhe një ndërhyrje e aspektit ligjor. Një nga zgjidhjet që zoti {...} shtron, mund të ishte për shembull krijimi i një seksioni/njësie i/e cila të analizonte përkohësisht grup-çështje duke i grupuar këto çështje në bazë të institutit të së drejtës e kështu Gjykata e Lartë mund të japë vendime pilot duke reduktuar kështu kohën me zgjidhjen e 2-3 çështjeve njëherësh.

Gjithashtu, zoti {...} përmend edhe rastet e shumë rekurseve të cilat janë abuzive në mendimin e tij, dhe se duhet të merret masë për këto abuzivitete që i kryen avokati dhe që i faturon shoqëria. Por në bindjen e tij, me zgjedhjen e gjyqtarëve të duhur, do të krijohet një gjykatë efektive dhe me krijimin e një gjykate efektive do të ulet numri i pretendimeve abuzive dhe si rrjedhojë edhe numri i rekurseve.

Pyetja e fundit për zotin {...}, drejtohet nga zonja Marçela Shehu, e cila e pyet *mbi dilemën etike më sfiduese që ka pasur në punë dhe si e ka zgjidhur atë.*

Zoti {...} shpjegon që është rritur në një familje intelektualësh të cilët e kanë rritur me parimin për të qenë i drejtë, i sinqertë, i ndershëm. Zoti {...} shton që ai ka qenë objekt i së keqes por ka mbijetuar duke mos prishur karakterin e tij, falë formimit që ka marrë duke qenë autokritik e duke kërkuar shumë nga vetja.

Ai shprehet se për një pedagog, rasti më flagrant është nota e një studenti i cili kërkon rritje note, pra në njëfarë mënyre duke kërkuar kështu daljen nga normat e etikës. Dilema nuk ka qenë tek rritja e notës por ka qenë bindja e studentit për të mos e kërkuar atë notë pasi ai ishte vlerësimi që meritonte dhe se nëse do t'i jepte një vlerësim tjetër do ta gënjente atë dhe shoqërinë.

Gjithashtu zoti {...} përmend edhe faktin që duke qenë avokat i janë kërkuar edhe kërkesa abuzive, të cilat ai nuk ka pranuar duke mos dalë nga karakteri i etikës profesionale.

(Me këtë përgjigje përfundon edhe intervista e zotit {...}, i cili pasi falënderon anëtarët e Këshillit, largohet nga salla e mbledhjes.)

(Hyn në sallën e mbledhjes kandidati zoti {...}.)

Fillimisht zotit {...} i bëhet e ditur që intervistomi do të zgjasë 30 minuta dhe më pas i parashtrohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Naureda Llagami, pyetja e parë e cila lidhet me **arsyet, motivet dhe objektivat e kandidimit që synon të ndjekë zoti {...}, në qoftë se do të ishte nesër një anëtar i Gjykatës së Lartë në pozicionin e së drejtës penale.**

Merr fjalën zoti {...}, i cili fillimisht bën një prezantim të shkurtër të karrierës së tij që nga eksperiencia e tij në Sektorin e Hetimit të Veprave Penale e më pas në administratën publike në Ministrinë e Drejtësisë në Drejtorinë e Kodifikimit. Zoti {...} gjatë kësaj kohe ka kryer studimet master, më pas ka përfunduar edhe doktoraturën në fushën penale, fushë në të cilën ai ka kandiduar.

Gjatë kësaj kohe, shton zoti {...}, aktiviteti i tij profesional ka vazhduar duke marrë pjesë në veprimtari të ndryshme shkencore, në disa grupe pune për studimin, konsultimin dhe hartimin e legjislacionit. Gjithashtu, zoti {...} flet shkurtimisht edhe mbi mësimdhënien në fushën penale dhe mbi hartimin e një sërë botimesh dhe artikujsh shkencorë dhe pjesëmarrjen në konferenca.

Më pas zoti {...} përmend eksperiencën në fushën e kodifikimit, në fushën e avokatisë, në fushën e mësimdhënies, në fushën e administratës si disa nga motivet që e shtynë për të kandiduar.

Gjithashtu, zoti {...} përmend edhe disa nga objektivat që duhet të ketë kandidati për gjyqtar. Zoti {...} i konsideron këto objektiva i) të përgjithshme për çdo kandidat gjyqtar dhe ii) të veçanta vetëm për Gjykatën e Lartë. Në objektivat e përgjithshme hyn zbatimi i parimeve të ushtrimit të pushtetit gjyqësor, vlerat themelore në ushtrimin e funksionit, standardet e etikës dhe zbatimi i rregullave procedurale. Evidentimi dhe zbatimi i normave procedurale, ku të dallohet përqsja e vendimeve të pasakta të cilat

herë pas here kanë rënë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Objektivi tjetër që liston zoti {...} është problemi i sasisë së madhe të mbledhur i çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Lartë dhe rrugët për të çuar në evadimin e tyre mund të jenë të ndryshme.

Një objektivi tjetër, zoti {...} përmend edhe marrëdhëniet e krijuara nga ndryshimet kushtetuese me Këshillin e Lartë Gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka përmendur këtë edhe në objektivat e tij prandaj sipas Zotit {...}, ato duhet të përbëjnë një marrëdhënie profesionale, institucionale ndërmjet të dy institucioneve.

Më pas zoti {...} pyetet nga zoti Maksim Qoku se ***cilët elementë të formimit dhe të eksperiencës profesionale e kanë përgatitur atë për të adresuar çdo aspekt që lidhet me juridiksionin e Gjykatës së Lartë.***

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, zoti {...} mendon se eksperiencia në Drejtorinë e Kodifikimit (në Ministrinë e Drejtësisë) që lidhet me arsyetimin dhe me shkrimin ligjor dhe me teknikën legjislativë; eksperiencia në mësimdhënie; eksperiencia në mjaft grupe pune dhe komunikimi ndërpersonal me ta; këto janë disa nga elementët e formimit.

Ndër të tjera ai shton që disa elementë të formimit janë edhe disa veprimtari gati-gati gjyqësore siç është pjesëmarrja në Bordin e Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, pjesëmarrja në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv dhe pjesëmarrja e tij si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke përmendur këtu vendimet kolegjiale për procedimin disiplinor të gjyqtarëve.

Pyetja e tretë i drejtohet nga zoti Erjon Muharremaj i cili e pyet ***mbi rolin e Gjykatës së Lartë përtej sistemit gjyqësor dhe më gjerë në shoqëri.***

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, zoti {...} është i mendimit se Gjykata e Lartë ka atë rol që i jep Kushtetuta, duke përmendur këtu edhe rolin shtesë tashmë atë të zhvillimit të praktikës gjyqësore. Në këtë drejtim, vendimet e Gjykatës së Lartë duhet të jenë të arsyetuara dhe bindëse në formë detyruese për gjykatat e shkallës së parë, apelit dhe pjesëmarrësit në proceset gjyqësore. Zoti {...} vazhdon mendimin e tij duke shtuar se

Gjykata e Lartë, nëpërmjet veprimtarisë së saj, duhet të udhëzojë dhe të bindë palët pjesëmarrëse (avokatët dhe prokurorët) që për të shkuar në Gjykatën e Lartë duhet të studiohet jo vetëm ligji por edhe praktika. Gjykata e Lartë tani e tutje ka mundësinë të punojë si pjesë e administrimit të pushtetit gjyqësor, në marrëdhënie me institucionet e tjera, duke përdorur KLGJ-në.

Zonja Brikena Ukperaj i drejton pyetjen e katërt zotit {...}, e cila ka të bëjë me çështjen e backlog-ut një nga sfidat që ka sot Gjykata e Lartë dhe konkretisht ***cilat mund të jenë masat konkrete që mund të merren menjëherë për uljen e backlog-ut dhe që do të ishte e prekshme edhe për publikun.***

Sa i përket kësaj pyetjeje, zoti {...} jep disa shembuj për marrjen e masave për reduktimin e backlog-ut në Gjykatën e Lartë. Ai mendon se fillimisht, duhet të fillohet me evadimin e atyre çështjeve që janë emergjente, më pas mund të ketë një ndarje të fushave duke angazhuar ndihmësit ligjorë dhe duke i specializuar ata.

Organizimi dhe angazhimi i ndihmësve ligjorë, duke i ndarë në nivele dhe këtu zoti {...} i referohet eksperiencës së Kosovës ku ndihmësit ligjorë janë të ndarë me nivele (ndihmësit që shqyrtojnë çështjet e thjeshta, ndihmësit që shqyrtojnë çështje pak më të ndërlikuar dhe ndihmësit që shqyrtojnë çështje shumë më të ndërlikuara).

Gjithashtu, zoti {...} jep shembullin edhe të Gjykatës së Kroacisë e cila ka një sektor që certifikon vendimet unifikuese nga ana e sigurisë juridike, në mënyrë që ato mos të jenë në kontradiktë me praktika të tjera të mëparshme.

Pyetja e fundit për zotin {...}, drejtohet nga zonja Marçela Shehu, e cila e pyet ***mbi dilemën etike më sfiduese që ka pasur në punë dhe si e ka zgjidhur atë.***

Një ndër dilemat që zoti {...} ka hasur në jetën e tij ka qenë ajo e të punuarit në shtet apo në sektorin privat dhe zgjedhja nuk ka qenë e lehtë, pasi ishte një kontradiktë që vinte midis sigurisë së të ardhurave financiare dhe të panjohurës që e priste në sektorin privat dhe zgjedhja e tij rezultoi e suksesshme duke mundësuar alternim të aktivitetit

publik me atë privat.

Një tjetër dilemë, zoti {...} përmend edhe atë midis të qëndruarit në Shqipëri apo të largimit në një shtet tjetër, duke zgjedhur kështu qëndrimin në Shqipëri.

(Me këtë përgjigje përfundon edhe intervista e zotit {...}, i cili largohet nga salla e mbledhjes. Gjithashtu, me largimin e zotit {...}, largohen nga salla e mbledhjes edhe kameramanët të cilët ndoqën të tre intervistat e kandidatëve.)

Pas përfundimit të intervistave nga tre kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, zonja Llagami njofton se seanca shtyhet për t'u mbledhur sërish në orën 13:00, për t'i lënë kështu mundësi të gjithë anëtarëve të bëjnë vlerësimin për të tre kandidatët.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 27.02.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Vijimi i procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit përfundimtar të kandidatëve, që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, civile dhe penale, deri në propozimin për emërim.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:03 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 12. Charles Ericksen, USAID.*
- 13. Erion Fejzulla, USAID.*
- 14. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 15. Valbona Bala, USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Vijimi i procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit përfundimtar të kandidatëve, që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e

libre, në fushën e të drejtës administrative, civile dhe penale, deri në propozimin për emërim.

Rifillon seanca në orën 13:29

Pas dëgjësës me tre kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, anëtarët e Këshillit u tërhoqën për të bërë vlerësimin e tyre për secilin kandidat dhe paraprakisht pyeten nga Kryetarja e Këshillit, zonja Llagami nëse kanë ndonjë sugjerim përpara.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë sugjerime, prandaj i jepet fjala relatorit për vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit z. {...}.

Merr fjalën relatori, zoti Alban Toro, i cili shprehet se edhe në përfundim të intervistimit të kandidatit, nuk ka ndryshim të vlerësimit dhe është i njëjtë me atë të aktit paraprak të vlerësimit. Në total zoti {...} është vlerësuar me 87 pikë (zoti Toro lexon vlerësimin përfundimtar sipas kategorive, kriterëve apo treguesve përkatës).

Merr fjalën anëtari tjetër i Komisionit, zoti Ilir Toska, i cili shprehet se vlerësimi i tij për kandidatin z. {...} është i njëjtë duke e vlerësuar atë me 87 pikë, me po të njëjtin vlerësim sipas kategorive dhe treguesve që janë miratuar më herët.

Merr fjalën anëtarja tjetër e Komisionit, zonja Marçela Shehu, e cila shprehet se vlerësimi i saj për kandidatin z. {...} është i njëjtë me atë të relatorit duke e vlerësuar atë me 87 pikë bazuar në argumentet që u parashtruar edhe në mbledhjen e një dite më parë nga relatori si dhe nga dëgjësja e intervistës së sotme.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Maksim Qoku, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotën {...} me 87 pikë. Zoti Qoku ia dorëzon dokumentin e firmosur kryetarit të Komisionit.

Merr fjalën anëtarja e Këshillit, zonja Brunilda Kadi, e cila shprehet se e ka vlerësuar zotën {...} me 87 pikë, me arsyetim pothuajse të njëjtë me atë të aktit paraprak të vlerësimit. Zonja Kadi ia dorëzon aktin e vlerësimit me shkrim të nënshkruar relatorit, zotit Toro.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Dritan Hallunaj, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 87 pikë, vlerësim i njëjtë me atë të aktit paraprak të vlerësimit. Zoti Hallunaj ia dorëzon aktin Komisionit.

Merr fjalën anëtarja e Këshillit, zonja Fatmira Luli, e cila shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 87 pikë, bazuar edhe në intervistën e mëparshme dhe duke gjykuar që vlerësimi i relatorit ishte i drejtë. Zonja Luli ia dorëzon këtë akt të firmosur Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Erjon Muharremaj, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 87 pikë, duke menduar se metodologjia e pikëzimit është tepër e detajuar dhe nuk lë hapësirë për subjektivizëm, vlerësim ky i njëjtë me atë të aktit paraprak të vlerësimit. Zoti Muharremaj ia dorëzon aktin e firmosur Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën anëtarja e Këshillit, zonja Brikena Ukperaj, e cila shprehet se e ka vlerësuar zoti {...} me 87 pikë, duke u bazuar në interpretimet dhe argumentimet e bëra në seancën e djeshme nga relatori i çështjes si dhe në të dhënat që u morën në seancën dëgjimore. Zonja Ukperaj ia dorëzon aktin e firmosur Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Medi Bici, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 87 pikë, duke qenë i të njëjtit mendim për të gjitha rubrikat e aktit të vlerësimit ashtu si vlerësimi paraprak. Zoti Bici ia dorëzon aktin të nënshkruar në të gjitha faqet zotit Toro.

Merr fjalën Kryetarja e Këshillit, zonja Naureda Llagami, e cila shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 87 pikë, duke qenë kështu dakord me vlerësimin paraprak të bërë nga relatori i çështjes. Zonja Llagami ia dorëzon aktin e nënshkruar Komisionit.

Më pas i jepet fjala relatorit për vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit z. f...l.

Merr fjalën relatorja, zonja Marçela Shehu, e cila shprehet se edhe pas dëgjësës dhe intervistës së dhënë nga kandidati, nuk ka ndryshim të vlerësimit dhe është i njëjtë

me atë të aktit paraparak të vlerësimit. Në total zoti {...} është vlerësuar me 84 pikë.

Merr fjalën anëtari tjetër i Komisionit, zoti Ilir Toska, i cili shprehet se vlerësimi i tij për kandidatin z. {...} është i njëjtë duke e vlerësuar atë me 84 pikë, me po të njëjtin vlerësim sipas kategorive dhe treguesve që janë miratuar më herët. Në disa momente të veçanta, referuar intervistës, janë bërë në aktin me shkrim edhe disa komente që do duhet të konsiderohen në vendimin e arsyetuar.

Merr fjalën anëtari tjetër i Komisionit, zoti Alban Toro, i cili shprehet se vlerësimi i tij për kandidatin z. {...} është i njëjtë me atë të relatores duke e vlerësuar atë me 84 pikë, bazuar edhe në intervistën që u zhvillua ditën e sotme. Zoti Toro ia dorëzon aktin relatores.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Maksim Qoku, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 84 pikë. Zoti Qoku ia dorëzon dokumentin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën anëtarja e Këshillit, zonja Brunilda Kadi, e cila shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 84 pikë, vlerësim i njëjtë me atë të relatorit. Zonja Kadi ia dorëzon aktin e vlerësimit me shkrim të nënshkruar relatorit.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Dritan Hallunaj, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 84 pikë, vlerësim i njëjtë me atë të aktit paraparak të vlerësimit. Zoti Hallunaj ia dorëzon aktin Komisionit.

Merr fjalën anëtarja e Këshillit, zonja Fatmira Luli, e cila shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 84 pikë, bazuar edhe në propozimin e bërë nga relatorja. Zonja Luli ia dorëzon këtë akt të firmosur Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Erjon Muharremaj, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 84 pikë, duke i qëndruar vlerësimit të bërë nga relatorja. Zoti Muharremaj ia dorëzon aktin e firmosur në çdo fletë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën anëtarja e Këshillit, zonja Brikena Ukperaj, e cila shprehet se e ka vlerësuar zoti {...} me 84 pikë, duke mos patur ndryshim nga akti paraparak i vlerësimit gjithashtu edhe duke u bazuar në interpretimet dhe argumentimet e bëra në seancën e

djeshme nga relatori i çështjes dhe duke shtuar edhe disa argumentime shtesë të cilat të mund të konsiderohen në përpilimin e aktit të vlerësimit përfundimtar.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Medi Bici, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 84 pikë, duke qenë i të njëjtit mendim për të gjitha rubrikat e aktit të vlerësimit ashtu si vlerësimi paraparak. Zoti Bici ia dorëzon aktin relatores.

Merr fjalën Kryetarja e Këshillit, zonja Naureda Llagami, e cila shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 84 pikë, duke qenë kështu dakord me vlerësimin paraparak të bërë nga relatorja e çështjes. Zonja Llagami ia dorëzon aktin relatores.

Më pas i jepet fjala relatorit për vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit z. {...}.

Merr fjalën relatori, zoti Ilir Toska, i cili shprehet se vlerësimi për zotin {...} është i njëjtë sikundër vlerësimi paraparak i bërë ditën e djeshme, ku në total zoti {...} është vlerësuar 86 pikë (zoti Toska lexon vlerësimin përfundimtar sipas kategorive, kritereve apo treguesve përkatës). Në aktin me shkrim është shtuar edhe një arsyetim duke u bazuar në intervistën e mëparshme të kandidatit.

Merr fjalën anëtarja tjetër e Komisionit, zonja Marçela Shehu, e cila shprehet se vlerësimi i saj për kandidatin z. {...} është i njëjtë duke e vlerësuar atë me 86 pikë, me po të njëjtin vlerësim sipas kategorive dhe treguesve që janë miratuar më herët.

Merr fjalën anëtari tjetër i Komisionit, zoti Alban Toro, i cili shprehet se vlerësimi i tij për kandidatin z. {...} është i njëjtë me atë të relatorit duke e vlerësuar atë me 86 pikë. Zoti Toro e dorëzon një kopje për administrim.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Maksim Qoku, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 86 pikë. Zoti Qoku ia dorëzon aktin e firmosur Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën anëtarja e Këshillit, zonja Brunilda Kadi, e cila shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 86 pikë, vlerësim i njëjtë me atë të relatorit. Zonja Kadi e dorëzon aktin e vlerësimit me shkrim të nënshkruar.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Dritan Hallunaj, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 86 pikë, vlerësim i njëjtë me atë të aktit paraprak të vlerësimit. Zoti Hallunaj ia dorëzon aktin Komisionit.

Merr fjalën anëtarja e Këshillit, zonja Fatmira Luli, e cila shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 86 pikë, bazuar edhe në propozimin e bërë nga relatori. Zonja Luli ia dorëzon këtë akt të firmosur Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Erjon Muharremaj, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 86 pikë, duke i qëndruar vlerësimit të bërë nga relatori. Zoti Muharremaj ia dorëzon aktin e firmosur në çdo fletë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën anëtarja e Këshillit, zonja Brikena Ukperaj, e cila shprehet se e ka vlerësuar zoti {...} me 86 pikë, duke u bazuar në argumentimin e relatorit dhe në aktin paraprak të vlerësimit dhe duke marrë parasysh edhe intervistën e mëparshme të kandidatit. Në aktin që dorëzohet ka edhe disa argumentime shtesë të cilat zonja Ukperaj kërkon që të merren parasysh nga relatori.

Merr fjalën anëtari i Këshillit, zoti Medi Bici, i cili shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 86 pikë. Zoti Bici ia dorëzon aktin relatorit.

Merr fjalën Kryetarja e Këshillit, zonja Naureda Llagami, e cila shprehet se e ka vlerësuar zotin {...} me 86 pikë, duke qenë kështu dakord me vlerësimin paraprak të bërë nga relatori i çështjes. Zonja Llagami ia dorëzon aktin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Hapi tjetër që duhet të ndiqet nga relatorët është ai i plotësimit të projektvendimit të vlerësimit përfundimtar dhe për këtë kërkohet 5 minuta pushim nga zoti Toska.

Pas përfundimit të plotësimit nga të tre relatorët të projektvendimit të vlerësimit përfundimtar për të tre kandidatët, rezulton si më poshtë:

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatit z. {...}, si më poshtë:

A. Kategoria “Meritat profesionale”:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”:
 - a) Nënkriteri “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi” - 2 pikë;
 - b) Nënkriteri “Rezultatet e programeve të formimit fillestar” - 0 pikë;
 - c) Nënkriteri “Rezultatet e përvojës në profesion” - 4 pikë;
 - ç) Nënkriteri “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:
 - I) Treguesi “Rezultatet e trajnimeve të tjera” - 0 pikë;
 - II) Treguesi “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare” - 2 pikë;
 - III) Treguesi “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë” - 4 pikë;
 - d) Nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” - 1 pikë;
2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”:
 - a) Indikator “Origjinaliteti dhe/ose impakti” - 5 pikë;
 - b) Indikator “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” - 5 pikë;
 - c) Indikator “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” - 5 pikë;
 - ç) Indikator “Interpretimi i harmonizuar” - 5 pikë;
 - d) Indikator “Referencat e praktikës gjyqësore” - 5 pikë;
3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”:
 - a) Nënkriteri “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” - 6 pikë;
 - b) Nënkriteri “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” - 6 pikë;
 - c) Nënkriteri “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” - 4 pikë;
 - ç) Nënkriteri “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”:
 - I) Treguesi “Pjesëmarrja në konferenca shkencore” - 4 pikë;
 - II) Treguesi “Mësimdhënie” - 4 pikë;
 - III) Treguesi “Çmime dhe tituj” - 0 pikë;
- B. Kategoria “Meritat morale dhe etike”:
 1. Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” - 5 pikë;

2. Kriteri “Nderi dhe dinjiteti” - 5 pikë;

3. Kriteri “Reputacioni” - 5 pikë;

C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”:

1. Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” - 2 pikë;

2. Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” - 4 pikë;

3. Kriteri “Aftësitë e komunikimit” - 2 pikë;

4. Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” - 2 pikë; me një total prej 87 pikësh.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga relatori zoti Toro, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi të vlerësojë përfundimisht kandidatin z. {...} me 87 pikë.

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatit z. {...}, si më poshtë:

A. Kategoria “Meritat profesionale”:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”:

a) Nënkriteri “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi” - 2 pikë;

- b) Nënkriteri “Rezultatet e programeve të formimit fillestar” - 0 pikë;
 - c) Nënkriteri “Rezultatet e përvojës në profesion” - 4 pikë;
 - ç) Nënkriteri “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:
 - I) Treguesi “Rezultatet e trajnimeve të tjera” - 0 pikë;
 - II) Treguesi “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare” - 2 pikë;
 - III) Treguesi “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë” - 4 pikë; - d) Nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” - 2 pikë;
2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”:
- a) Indikatorit “Origjinaliteti dhe/ose impakti” - 5 pikë;
 - b) Indikatorit “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” - 5 pikë;
 - c) Indikatorit “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” - 5 pikë;
 - ç) Indikatorit “Interpretimi i harmonizuar” - 5 pikë;
 - d) Indikatorit “Referencat e praktikës gjyqësore” - 5 pikë;
3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”:
- a) Nënkriteri “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” - 6 pikë;
 - b) Nënkriteri “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” - 6 pikë;
 - c) Nënkriteri “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” - 0 pikë;
 - ç) Nënkriteri “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”:
 - I) Treguesi “Pjesëmarrja në konferenca shkencore” - 4 pikë;
 - II) Treguesi “Mësimdhënie” - 4 pikë;
 - III) Treguesi “Çmime dhe tituj” - 0 pikë;
- B. Kategoria “Meritat morale dhe etike”:
- 1. Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” - 5 pikë;
 - 2. Kriteri “Nderi dhe dinjiteti” - 5 pikë;
 - 3. Kriteri “Reputacioni” - 5 pikë;

C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”:

1. Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” - 2 pikë;
2. Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” - 4 pikë;
3. Kriteri “Aftësitë e komunikimit” - 2 pikë;
4. Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” - 2 pikë; me një total prej 84 pikësh.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga relatorja zonja Shehu, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Marçela Shehu është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi të vlerësojë përfundimisht kandidatin z. {...} me 84 pikë.

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatit z. {...}, si më poshtë:

A. Kategoria “Meritat profesionale”:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”:

- a) Nënkriteri “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi” - 2 pikë;
- b) Nënkriteri “Rezultatet e programeve të formimit fillestar” - 0 pikë;
- c) Nënkriteri “Rezultatet e përvojës në profesion” - 4 pikë;

- ç) Nënkriteri “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:
- I) Treguesi “Rezultatet e trajnimeve të tjera” - 0 pikë;
- II) Treguesi “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare” - 2 pikë;
- III) Treguesi “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë” - 2 pikë;
- d) Nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” - 2 pikë;
2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”:
- a) Indikatorit “Origjinaliteti dhe/ose impakti” - 5 pikë;
- b) Indikatorit “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” - 5 pikë;
- c) Indikatorit “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” - 5 pikë;
- ç) Indikatorit “Interpretimi i harmonizuar” - 5 pikë;
- d) Indikatorit “Referencat e praktikës gjyqësore” - 5 pikë;
3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”:
- a) Nënkriteri “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” - 6 pikë;
- b) Nënkriteri “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” - 6 pikë;
- c) Nënkriteri “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” - 4 pikë;
- ç) Nënkriteri “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”:
- I) Treguesi “Pjesëmarrja në konferenca shkencore” - 4 pikë;
- II) Treguesi “Mësimdhënie” - 4 pikë;
- III) Treguesi “Çmime dhe tituj” - 0 pikë;
- B. Kategoria “Meritat morale dhe etike”:
1. Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” - 5 pikë;
2. Kriteri “Nderi dhe dinjiteti” - 5 pikë;
3. Kriteri “Reputacioni” - 5 pikë;
- C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”:
1. Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” - 2 pikë;

2. Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” - 4 pikë;
3. Kriteri “Aftësitë e komunikimit” - 2 pikë;
4. Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” - 2 pikë; me një total prej 86 pikësh.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga relatori zoti Toska, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Ilir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Maksim Qoku është dakord.
Brunilda Kadi është dakord.
Dritan Hallunaj është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi të vlerësojë përfundimisht kandidatin z. {...} me 86 pikë.

Hapi tjetër që duhet të ndiqet nga anëtarët e Këshillit është procedura e renditjes së kandidatëve.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të miratojë renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1. Z. {...}.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga Komisioni, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Alban Toro është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Miratimin e renditjes së kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1. Z. {...}.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të miratojë renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1. Z. {...}.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga Komisioni, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Marçela Shehu është dakord.

Alban Toro është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.
Dritan Hallunaj është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Miratimin e renditjes së kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1. Z. {...}.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të miratojë renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1. Z. {...}.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga Komisioni, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Illir Toska është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Alban Toro është dakord.
Maksim Qoku është dakord.
Brunilda Kadi është dakord.
Dritan Hallunaj është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Miratimin e renditjes së kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1. Z. {...}.

Hapi i fundit që duhet të ndiqet nga anëtarët e Këshillit është propozimi për emërim të kandidatëve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet projektvendimit i propozon Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Alban Toro është dakord.

Illir Toska është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}. Një kopje e

vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet projektvendimit i propozon Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Marçela Shehu është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet projektvendimit i propozon Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Ilir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Maksim Qoku është dakord.
Brunilda Kadi është dakord.
Dritan Hallunaj është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor